



BASHKIA
TIRANË

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 48, datë 31.05.2017

PËR

**“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 27, DATË 05.04.2017 TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR
MIRATIMIN E KUOTËS DITORE NË QENDRAT SOCIALE”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja (b), nenit 24, pika 2 , nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 113 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, për “Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” (i ndryshuar); Vendimit nr. 59, datë 29.10.2007 të Këshillit Bashkiak “Për krijimin dhe funksionimin e menciës në Qendrën Sociale “Të qëndrojmë së bashku” si dhe miratimin e një ndryshimi në strukturë”; vendimit nr. 4, datë 01.03.2012 të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, dhe miratimi i strukturës organizative”; vendimit nr. 11, datë 05.04.2012 të Këshillit Bashkiak “Për ristrukturimin e Qendrës Sociale “Të Qëndrojmë së Bashku”, “Qendrës Komunitare Multidisiplinare për Fëmijët dhe Familjet në Nevojë” dhe “Qendrës Komunitare për të Moshuarit”, miratimin e strukturave të tyre organizative si dhe rishpërndarjet në Buxhetin e Bashkisë së Tiranës për vitin 2012”; vendimit nr. 60, datë 24.12.2012 të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e ”Qendrës Komunitare Shkozë” dhe miratimin e strukturës së saj organizative si dhe një shtesë në numrin e përgjithshëm të strukturës organizative të Qendrës Sociale ”Të qëndrojmë së bashku”, ”Qendrës Sociale Multidisiplinare” dhe Qendrës Sociale "Shtëpia e Përbashkët”; udhëzimit nr. 5, datë 1.8.2012 të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror” (i ndryshuar); vendimit nr. 84 datë 29.12.2016 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017” (i ndryshuar) me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Në pikën 5 të vendimin nr. 27, datë 05.04.2017 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e kuotës ditore në qendrat sociale”, pas fjalëve “Qendra Sociale të Qëndrojmë së Bashku” shtohet togfjalëshi“ dhe “Qendra Komunitare Shkozë”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social, “Qendra Sociale Multidisiplinare”, “Qendra Sociale Shtëpia e Përbashkët”, “Qendra Sociale të Qëndrojmë së Bashku” dhe “Qendra Komunitare Shkozë” nën administrimin e Bashkisë Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETAR

ALDRIN DALIPI